ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **MINISTRIA E ARSIMIT**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **208 UDHEHEQESI-24-508-5-2-1**

Sa i përket tenderit për ***Ndërtimi i bazës se themeleve në Pilota për SHFMU "Milaim Krasniqi" në fshatin Pastasel-Rahovec***

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

GOE : "PROGRESS" LLC & "ALBINI CONSTRUCTION" Sh.P.K
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rr. "Xhevë e Fehmi Lladrivci"
(Adresa)

Gllogoc (Vendi)

13000 (Kodi postar)

+383-48-854-677 (Numri Telefonit)

N/A (Numri i Faks-it)

BEQIR HETA
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

nptprogress@gmail.com
(Adresa elektronike)

15/04/2024
(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

L.L.C PROGRES GJILOGOC

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës","Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftimi për Kontrate – 29/01/2024 Hapja e Ofertave – 20/02/2024 Njoftimi mbi vendimin e AK-se – 29/03/2024 Kerkesa për ri-shqyrtim – 03/04/2024 Vendimi i AK-se për refuzim te Kërkesës – 05/04/2024

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

Hapja e tenderit është bërë në mënyrë elektronike me datë **20/02/2024** në ora 14:00.

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒ **Jo** ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po [X] Jo [ ]

Grupi i OE-ve "PROGRESS" LLC & "ALBINI CONSTRUCTION" Sh.P.K me date 03/04/2024, ka parashtruar Kërkesë për Ri-shqyrtim kundër Njoftimit mbi vendimin e AK-se te datës 29/03/2024, me te cilin vendim është propozuar për dhënie te kontratës Grupi i Operatoreve Ekonomik "Sopi Group" Sh.P.K. & "NPN Euroing" Sh.P.K., ndërsa ne si grup jemi eliminuar me arsyetimin se nuk kemi plotesuar deklaratat e secilit Operator Ekonomik, dhe se nuk kemi permbushur kerkesat e Kapacitetit teknik dhe Profesional.

GOE ankues kundër Njoftimit te lartë cituar, me date 03/04/2024 ka paraqitur Kërkesë për Ri-shqyrtim, ndërsa me date 05/04/2024, AK – Ministria e Arsimit ka refuzuar Kerkesen tone për ri-shqyrtim si te pabazuar.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Për shkak të shkelje të dispozitave të;

- Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, (në tekstin e mëtejmë do të i referohemi LPP-së) dhe atë;

- Nenin 6, Ekonomiciteti dhe Efikasiteti, par 1.
- Nenin 7, Barazia në trajtim/Jo diskriminimi, par 1, 2 dhe 6
- Neni 10, Qasja në dokumentacion
- Nenin 56, Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave, par 1, nen par 1.1 ; 1.2 dhe par 3.
- Nenin 59, Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve, par 2 dhe 4
- Nenin 60, Kriteret për Dhënien e Kontratës, par 1, nen par 1.1
- Nenin 69, Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale, par 1.
- Nenin 72 të LPP-së, të Dokumentacioni dhe informacioni shtesë, par 1 dhe

II. Dispozitat e Rregullores nr. 01/2022 të prokurimit publik (në tekstin e mëtejmë do të i referohemi RRPP) dhe atë:

- Nenin 38, Sqarimi i Tenderëve, par 38.1
- Nenin 40, Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve, par 40.1; 40.2; 40.6 nen par a; b dhe c dhe neni 40 pika 12.

- Nenin 97, Shkeljet e rënda, par 97.1 nen (d) dhe (o)

III. Dispozitat e Udhëzuesit nr. 01/2023 të prokurimit publik (në tekstin e mëtejmë do të i referohemi UA2) dhe atë:

- 10. Sqarimi i tenderëve gjatë procesit të vlerësimit të tenderëve, AK duhet të veproj në përputhje me nenin 59 pika 4 të LPP-së.

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Te nderuar,

Grupi i OE-ve ankues "PROGRESS" LLC & "ALBINI CONSTRUCTION" Sh.P.K, me daten 03/04/2024, ne kuptim te nenit 108/A te LPP-se, ka parashtruar kerkese per rishqyrtim dhe ka kundershtuar Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues – Ministria e Arsimit, për aktivitetin me titull: ***"Ndërtimi i bazës se themeleve në Pilota për SHFMU "Milaim Krasniqi" në fshatin Pastasel-Rahovec"*** e me nr. te prokurimit: **208 UDHEHEQESI-24-508-5-2-1.**

Autoriteti Kontraktues – Ministria e Arsimit, sipas vendimit te dates 05/04/2024, ka refuzuar kerkesen tone per ri shqyrtim dhe ka lene ne fuqi Njoftimin mbi Vendimin e AK-se, perkunder faktit se ne si grup kemi prezantuar prova dhe baze ligjore permes te ciles konfirmohet se kemi permbushur te gjitha kushtet dhe kriteret e percaktuara ne Dosje te Tenderit, prandaj ne kuptim te nenit 109, te LPP-se dhe ne afatin e parapare paraqesim kete:

A N K E S E

<u>Pretendimi ankimor 1:</u>

Autoriteti Kontraktues – Ministria e Arsimit, me datën 29/03/2024, ka publikuar njoftimin mbi Vendimin e AK-se, përkatësisht ne letren standarde te po te njejtes date, oferta e grupit tone është eliminuar me arsyjet se:

1. *Tek marreveshja e konzorciumit keni ofruar vetëm deklaratën e themelimit te grupit, mungojne deklaratat e secilit operator ekonomik ashtu siç percaktohet ne*

DT.

2. *OE duhet te te prezantoje se paku 12 punetor ne mesataren e te punesuarve ne 3 vitet e fundit, te certifikuar për ruajtje dhe siguri ne pune ne mesin e tyre armirues, manipulues i makinerise ndertimore, specialist i saldimit icertifikuar me IVS – kontratat e punetoreve nuk janë mbi themelimin e marredhenies se punes nga anetari i konzorciumit dhe si te tilla janë juridikisht te parregullta.*
3. *OE nuk ka qarkullim financiar te natyres se ngjashme ne tri vitet e fundit.*

Grupi i OE-ve ankues te njejtin arsyetim te eleminimit, me datën 03/04/2024, përmes kerkeses për rishqyrtim e ka kundershtuar arsyetimin e eleminimit, përkatësisht propozimin për dhenin e kontratës, ndërsa AK – MASHT me datën 05/04/2024 nxjerre vendim dhe refuzon ne tërësi si te pabazuar kerkesen tone për ri-shqyrtim.

Sa i përket arsyetimin te pare te eleminimit, AK – Ministria e Arsimit, përmes vlerësimit te ofertave si dhe përmes vendimit kundrejte Kërkesës për Rishqyrtim ka shkelur dispozitat ligjore ne tërësi pasi qe ne si OE ne oferte kemi prezantuar deklaratën e krijimit te grupit – konzorciumit ku ne te njejten janë te përcaktuara te gjitha obligimet ligjore ashtu siç percaktohet me nenin 71 te LPP-se lidhur me nenin 26 te Rregullores nr. 001/2022.

Prove: Deklarata mbi themelimin e konzorciumit.



DEKLARATA MBI THEMELIMIN E GRUPIT
Te nenshkruhet nga secili anetare i grupit apo konzerciumit qe aplikon

Per **MINISTRIA E ARSIMIT**
(me vazhdim: "autoriteti kontraktues")

Ne emer te Grupit: **"PROGRES " L.L.C** me numër fiskal **811288746**
(me vazhdim "tenderuesi") Titulli i aktivitetit te prokurimit

NDËRTIMI I BAZËS SE THEMELEVE NË PILOTA PËR SHFMU "MILAIM KRASNIQI" NË FSHATIN PASTASEL-RAHOVEC ME NR TE PROKURIMIT : 208 UDHEHEQESI-24-508-5-2-1

KJO LETËR E QËLLIMIT paraqet dhe deshmon se: **Palët e nënshkruara me poshtë**
Hyjnë ne bashkëpunim : Grup per qëllim te këtij tenderi me titull

NDËRTIMI I BAZËS SE THEMELEVE NË PILOTA PËR SHFMU "MILAIM KRASNIQI" NË FSHATIN PASTASEL-RAHOVEC ME NR TE PROKURIMIT : 208 UDHEHEQESI-24-508-5-2-1

Palët konfirmojne se

- Palët deklarojne qartë se si anëtarë te grupit janë, bashkëveprojnë dhe individualisht përgjegjës për permbajtjen e grupit te tenderit dhe, në rast se grupit i jepet kontrata, për ekzekutimin e kontratës.
- Palët deklarojnë qartë se si anëtarë te grupit duke konfirmuar qëndrimin e tyre në grup dhe se ata nuk janë duke marrë pjesë në mënyrë individuale dhe apo në ndonjë grup tjetër që marrin pjesë në procedurën e njëjtën te prokurimit.
- Palët deklarojnë qartë se si anëtarë te grupit janë **te pershtatshem** dhe do te sigurojnë deshmitë mbi penësitetshmërinë e tyre, siç është parashikuar ne paragrafin 6.4 te kesaj FDT.
- Palët deklarojnë qartë se si gjithë anëtarët e grupit autorizojnë partnerin kryesor **"PROGRES " L.L.C** me numër fiskal **811288746** per te veproval ne emër te grupit qe do te ate **Beqir Heta** personi i **autorizuar** per te nenshkruar Vendimin mbi caktimin e Menaxherit te projektit,Vendimin mbi menaxherin e punës, nënshkrimin e kontratës,deklaratat mbi garantimin e punëmëve,listën e stafit,listën e referencave,listën e pasjeve, njoftimin e sigurimit te tenderit, nënshkrimin e çmimeve, dhe sigurimin e ekzekutimit nëse rekomandohet për fitues.

1. Emri i Operatorit Ekonomik (Udhëheqësi) **"PROGRES " L.L.C** me numër fiskal **811288746**
2. Emri Mbiemri (Përfaqësuesi i autorizuar) **BEQIR HETA**

Data **20/02/2024** / Nënshkrimi

Perfaqesuesi i autorizuar **BEQIR HETA** do te nënshkruaj formularin e tenderit, njoftimet dhe çdo dokument tjetër, për të cilat është i autorizuar te nenshkruaj, në emër te Grupit, dhe qe rrjedhojë ne kundershtim me kërkesat e kesaj dosje te tenderit ose LPP-se

3. Emri i Operatorit Ekonomik **"ALBINI CONSTRUCTION" SH.P.K** me numër fiskal 811691136
Emri Mbiemri (Anëtari i Grupit) **JETON BERISHA**

Data **20/02/2024** / Nënshkrimi

Deklarata mbi themelimin e grupit i permban te gjitha kushtet ligjore te percaktuara me nenin 71 te LPP-se, peraktesisht nenin 26 te Rregullores për Prokurim Publik.

Neni 26 i Rregullores, par. 2 përcakton qe "*Deklaratat e kerkuara nga pika a, b dhe c, te paragrafit 26.1 mund te perfshihen ne një dokument*".

Neni 26 Grup i Operatorëve Ekonomik

- *26.1 Një tender mund të dorëzohet nga një grup i Operatorëve ekonomik. Në këtë rast grupi, me tenderin e tyre, duhet te:*
- *a. Dorëzon një deklaratë të qartë që të gjithë anëtarët e grupit janë së bashku dhe individualisht përgjegjës për përmbajtjen e tenderit të grupit, dhe në rast se grupit i jepet kontrata, për përformancën e kontratës;*
- *b. Dorëzon një deklaratë të nënshkruar nga secili nga anëtarët, që konfirmon pjesëmarrjen e tyre në grup dhe se nuk janë duke marrë pjesë individualisht dhe/ose në grupe tjera në procedurën e njëjtë të prokurimit (deklarata elektronike mund të nënshkruhet duke përdorur nënshkrimin elektronik të avancuar nëse është i aplikueshëm);*
- *c. Një deklaratë e nënshkruar nga të gjithë anëtarët të grupit për të autorizuar partnerin udhëheqës të veproj në emër të grupit (deklarata elektronike mund të nënshkruhet duke përdorur nënshkrimin elektronik të avancuar nëse është i aplikueshëm; dhe*
- *d. Secili anëtar i grupit duhet të jëtë i regjistruar në platformën elektronike, kërkesë e cila duhet të përcaktohet në dosje të tenderit. (Nënshkrimi digjital i avancuar nuk është i obligueshëm deri në njoftim zyrtar nga KRPP);*
- ***26.2 Deklaratat e kërkuara në (a), (b) dhe (c) të paragrafit 26.1, mund të përfshihen në një dokument.***

Grupi i OE-ve ankues, edhe ne kerkesen për ri-shqyrtim ne oferte përkatësisht ne kerkese për ri shqyrtim ka prezantuar deklaratën e krijimit te grupit – konzorciumit, ku janë te perfshira te gjitha kushtet ligjore por quditerisht AK – MASHT, tenton te elminoi ofertën e grupit tone si te pa pergjegjeshme duke shkelur parimet kryesore te prokurimit publik dhe duke tentuar te keqperdor paran publike. Vet Ministria e Arsimit, me deklarat te tille te perbashket ka lidhur me dhjetra kontrata ku neve si OE, posedojme dëshmi dhe prova, përkatësisht ne rast te procedurave eventuale tjera do ti prezantojme deshmit e tilla, përkatësisht edhe OSHP, deklaratat e tilla te perbashketa, i ka trajtuar si te mireqena.

- **Prove:** Vendimet e OSHP-se, për qeshtje identike i gjeni ne ueb faqen e OSHP-se

<u>Pretendimi ankimore 2.</u>

Sa i përket arsyetimit te dyte te ekeminimit, tek kerkesat e kapacitetit teknik dhe profesional, ne piken 9.1& 9.2, pozicioni 7 është kerkuar:

- *Lista e stafit te OE, se paku (12) punëtor ne mesataren e te punësuarve ne tri vitet e fundit, e qe kërkohen të jenë të certifikuar për ruajtjen dhe sigurinë në punë, në mesin e tyre të ketë edhe - Armirus - një - Manipulues i makinerise ndertimore – një - Specialist saldimi i certifikuar me IWS (International Welding Specialist) - një.*

Dëshmia e kërkuar dokumentare

- *Dëshmia 7. Listën e punëtorëve të operatorit ekonomik, e njëjta duhet të dorëzohet origjinal ose kopje e noterizuar. Kontratat ose parakontratat mbi marrëdhënien e punës të punëtorëve.*

Grupi i OE-ve ankues ne oferte ka prezantuar 6 inxhinier – staf te kualifikuar (Njëri nga ta i qertifikuar per saldim) dhe 2 (dy) teknik (për Armirim dhe MBS) si dhe 6 punëtor nga Lideri i grupit Progress LLC, Gjithsej 14 persona te prezantuar si staf profesional duke përfshirë edhe punonjësit.
Ndërsa nga anetari tjetër i grupit "Albini Construction" shpk janë prezantuar gjithesejt 10 punonjës tjerë, profesional dhe me qertifikata valide, të cilët janë në punishte për çdo ditë.

Kontratat e prezantuara ne oferte te gjitha janë valide, përkatësisht te njejtit janë te deklaruar edhe ne Administraten Tatimore te Kosovës.

- **Prove** lista e stafit te deklaruar ne ATK

Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Financave - Ministarstvo za Finansije - Ministry of Finance
Administrata Tatimore e Kosovës - Poreska Administracija Kosovo - Tax Administration of Kosovo

Lista e Punëtorëve

Periudha	2023		
Numri Fiskal	811169136	Kontakti	RAMIZ BERISHA
Tatimpaguesi	ALBINI CONSTRUCTION SH.P.K.	Adresa	
Regjioni	PRISHTINË 2	Tel	044/598 999
Lloji Kompanisë	SH.P.K.	Aktiviteti	Ndërtimi i objekteve banesore dhe jobanesore

Nr.	Emri	Nr. Personal	Primanu	MUAJT 1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12
1	DRITON BERISHA	1239495625	PO	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+
2	ERLIND BERISHA	1241564546	PO	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+
3	NAZMI HOXHAJ	1004123756	PO	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+
4	RAMIZ BERISHA	1014661269	PO	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+
5	EMRODIN BERISHA	2173874777	PO	-	-	-	+	+	+	+	+	+	+	+	+
6	ILIR HAJDARAJ	1174642512	PO	-	-	-	-	+	+	+	+	+	+	+	+
7	FEHMI HAJDARAJ	1004121372	PO	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+

4/2/2024 10:33:12 AM

[redacted]

8	RAGIP RAMA	1014002469	PO	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+
9	RASHKOM BERISHA	1014119210	PO	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+
10	ELBRSAN VELAKU	1174163479	PO	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+
11	JETON BERISHA	1173786551	PO	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+
12	LOMAN HOXHAJ	2019801787	PO	-	-	-	-	-	+	+	+	+	+	+	+

Autoriteti Kontraktues – MASHT, me arsyetim te tille te eleminimit, ka konsumuar shkelje ligjore nga neni 6, 7 59 dhe 69 i LPP-se, përkatësisht tentohet te abuzohet me

paran publike ku oferta jone ka dallim prej 57,367.64 euro ne raport me ofertën e operatorit ekonomi te rekomanduar për dhënie te kontratës. më ulët se i Rekomanduari për Fitues, përkatësisht ne si OE ne oferte kemi prezantuar te gjitha deshmit dhe provat përmes te cilave vertetohet se kemi prezantuar staf te mjaftueshem ashtu siç është kerkuar nga AK – MASHT.

- Prove: Lista e stafit dhe certifikimet e stafit i gjeni ne oferte.

Qeshtja e interpretimit te shkresave përkatësisht, kontratave te prezantuara ne oferte është qeshtje e cila nuk i takon Autoritetit Kontraktues dhe si e tille është aplikuar me arsye te caktuar, përkatësisht për qellim te lidhjes se kontratës me oferte dukshëm me te larte se oferta e grupit te OE-ve ankues. "PROGRESS" LLC & "ALBINI CONSTRUCTION" Sh.P.K.

Pretednimi ankimore 3.

Edhe arsyetimi i fundit i eleminimit te ofertës sonë paraqet shkelje esenciale te dispozitave ligjore për Prokurim Publik, pasi qe ne si grup i OE-ve ne oferte kemi prezantuar listën e projekteve te realizuara për gjat 3 viteve te fundit sipas kerkeses se përcaktuar ne dosje tenderit dhe njoftim për kontrate. Përkatësisht ne pozicionin 9.1&9.2, te kerkesave te kapacitetit teknik dhe profesional ne pozicionin 9 është kerkuar:

- *Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar* ***me sukses kontrata të natyrës se ngjashme*** *në tri vitet e fundit, në vlerë 375,000.00 euro.*
- Dëshmia e kërkuar dokumentare

- *Një Listë të punëve të natyrës se ngjashme të realizuara në tri vitet e shkuara nga data e publikimit duke saktësuar punët e kryera, shumën e kontratës, vendin, datën si dhe numrin eprokurimit, kjo listë duhet te jetë e nënshkruar dhe e vulosur nga operatori ekonomik (origjinal), po ashtu duke i bashkangjitur kopjet e referencave përkatëse ose raportet e pranimit teknik, si dëshmi se kontrata është përmbushur me sukses.*

Pra sipas kerkeses është kerkuar te prezantohen dëshmi për realizim te kontratave te ngjashme nuk është kerkuar realizim i kontratave te njejta, rrjedhimisht grupi i OE-ve ankues ne oferte ka prezantuar prova dhe dëshmi konkrete përmes te cilave vertetohet se mbulohet kerkesa kualifikuese, por quditerisht AK – MASHT, tenton te eleminoi ofertën tone si te pa pergjegjeshme dhe te lidhe kontrate me oferte e cila permban cmimin rreth 50,000.00 €, me te larte se oferta jone.

- **Prove** Lista e kontratave se bashku me dëshmi i gjeni ne plateformen e-prokurimi.

Bazuar ne provat dhe faktet e prezantuara si me larte Grupi i OE-ve ankues, vlerëson se AK –MASHT, vlerësimin krahasimin dhe ekzaminimin e ofertave e ka realizuar ne kundërshtim me ligjin për prokurim publik dhe me aktet tjera nënligjore prandaj, përmes kesaj ankese, kërkojmë nga OSHP, qe fillimisht te autorizoi ekspert shqyrtues,

proposional, i cili ne kuptim te nenit 113, te LPP-se, i trajton pretendimet tona ankimore ne formes siç është prezantuar ne ankese, ne atë mënyrë qe paneli shqyrtues te nxjerr këtë:

VENDIM

- **Te aprovohet** si e bazuar, ne tërësi ankesa e Grupit te OE-ve ankues.
- **Te kthehet lënda ne Rivlerësim** dhe te rekomandohet për dhënie te kontratës Grupi i OE-ve ankues,
- **Te lejohet** kthimi i mjeteve te deponuara n emer te ankeses.

Te ndërmerren masa tjera ndaj zyrtareve përgjegjës te AK-se, pasi qe ky proces i prokurimit është karakterizuar me shkelje te renda te ligjit për prokurim publik dhe te akteve tjera nënligjore përfshire edhe nenin 97, te Rregullores nr. 001/2022, përkatësisht ne si Grup i OE-ve posedojme prova dhe dëshmi reali përmes te cilave detyrohemi ti ndjekmi rruget tjera ligjore ne instanca tjera ligj zbatuese.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Te konsiderueshme.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,
f) Dëshminë e pagesës se tarifës se ankimit ne përputhje me nenin 118 te LPP-se, dhe
g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*